ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237,

ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Për: **MINISTRIA E INFRASTRUKTURES**

Për Aktivitetin e Prokurimit: **205-25-4397-2-1-1**

Sa i përket tenderit për: **Mirëmbajtja verore dhe dimërore e Rrugëve Nacionale dhe Rajonale të Kosovës për 3 vitet në vazhdim LOT 9 (Peja 1 dhe LOT 11 (Prishtina 1)**

A N K E S Ë

1. Identifikimi i OPERATORIT EKONOMIK

Grupi i OE "2A Group SH.P.K. & VIA EGNATIA SH.P.K."
(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Rr. Ali Pashe Tepelena,IVY Residence,1/14
(Adresa)

Prishtinë *(Vendi)*

10000 *(Kodi postar)*

+383 48666691 *(Numri Telefonit)*

(Numri i Faks-it)

Kushtrim Krivaqa
(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

info@2a-ks.com
(Adresa elektronike)

26/06/2026
(Data e parashtrimit të kërkesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i kërkesës mund ta parashtroj kërkesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse kërkesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

_____

(Emri i avokatit)

_____

(Adresa e plotë)

_____ _____

(Numri i Telefonit) *(Numri i faks-it)*

_____

(Adresa elektronike)

_____ _____

(Data e parashtrimit të kërkesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar "Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës", "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Kjo procedurë e prokurimit titullohet **"Mirëmbajtja verore dhe dimërore e Rrugëve Nacionale dhe Rajonale të Kosovës për 3 vitet në vazhdim"** dhe ka filluar me publikimin e njoftimit për kontratë në datën 27.05.2025.

Hapja e tenderëve është bërë më datë 26.11.2025 ashtu siç ka qenë e paraparë me Formularin standard për korrigjimin e gabimeve në njoftimet e publikuara të publikuar me datë 25.11.2025.

Njoftimi mbi Vendimin e AK-së është bërë publik me datën 29.12.2025 ku edhe ishim shpallur fitues për Lot-in 9 (Peja 1).

Të pakënaqur me këtë vendim disa OE kishin parashtruar Kërkesë për Rishqyrtim dhe ankesë në OSHP. Si pasojë OSHP e kishte kthye lëndën në ri-vlerësim për disa Lot-e. Pas rivlerësimit, AK me datë 04.06.2026 e ka publikuar Njoftimin mbi Vendimin e AK-së ku ne jemi eliminuar nga konkurrenca.

Të pakënaqur me këtë vendim dhe brenda afatit të rregullt kohor, me datë 09.06.2026 iu kemi drejtuar AK-së me Kërkesë për Rishqyrtim.

AK me datë 16.06.2026 e ka refuzuar si të pabazuar kërkesën tonë për rishqyrtim, andaj të pakënaqur me këtë vendim po i drejtohemi OSHP-së me ankesë.

Kriteri i vlerësimit - Tenderi i përgjegjshëm me **Çmimin më të ulët.**

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*
A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐ **Jo** ☒

Hapja e tenderëve është bërë me datë 26.11.2026 ndërsa në procesverbal nuk ishte evidentuar asnjë shkelje.

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*
A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☒ **Jo** ☐

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒ **Jo** ☐

Njoftimi mbi Vendimin e AK-së është bërë publik me datën 29.12.2025 ku edhe ishim shpallur fitues për Lot-in 9 (Peja 1).

Të pakënaqur me këtë vendim disa OE kishin parashtruar Kërkesë për Rishqyrtim dhe ankesë në OSHP. Si pasojë OSHP e kishte kthye lëndën në ri-vlerësim për disa Lot-e. Pas rivlerësimit, AK me datë 04.06.2026 e ka publikuar Njoftimin mbi Vendimin e AK-së ku ne jemi eliminuar nga konkurrenca.

Të pakënaqur me këtë vendim dhe brenda afatit të rregullt kohor, me datë 09.06.2026 iu kemi drejtuar AK-së me Kërkesë për Rishqyrtim.

AK me datë 16.06.2026 e ka refuzuar si të pabazuar kërkesën tonë për rishqyrtim, andaj të pakënaqur me këtë vendim po i drejtohemi OSHP-së me ankesë.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

1. AK ka shkelur nenin **1 të LPP-së**, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092;
2. AK ka shkelur nenin **7 të LPP-së**, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092;
3. AK ka shkelur nenin **56 të LPP-së**, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092;
4. AK ka shkelur nenin **59 të LPP-së**, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, dhe **40 të RRPP**-001/2022.
5. AK ka shkelur nenin **60 të LPP-së**, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092;
6. AK ka shkelur nenin **69 të LPP-së**, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092;
7. AK ka shkelur nenin **72 të LPP-së**, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, dhe nenin 38 i RRPP-001/2022.
8. AK ka shkelur nenin **108/A të LPP-së**,

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të kërkesës suaj për rishqyrtim.

KËRKESË PËR CAKTIMIN E NJË EKSPERTI TJETËR SHQYRTUES

Operatori Ekonomik kërkon që kjo lëndë të mos shqyrtohet nga eksperti i njëjtë që ka trajtuar rastin ton të mëparshme, por t'i caktohet një ekspert tjetër shqyrtues.

Kjo kërkesë bazohet në faktin se, sipas përvojës sonë në rastin e mëhershme të trajtuara nga i njëjti ekspert, janë aplikuar standarde të ndryshme vlerësimi për çështje të njëjta. Në raste të konkret operatorë të tjerë ekonomikë janë konsideruar të përgjegjshëm dhe janë shpallur fitues pavarësisht rrethanave të njëjta, ndërsa kompania jonë është eliminuar për të njëjtat arsye. Është e pakuptueshme dhe juridikisht e pajustifikueshme që i njëjti ekspert, për të njëjtat rrethana dhe për të njëjtat çështje, një operator ekonomik ta konsiderojë të përgjegjshëm dhe fitues, ndërsa një operator tjetër ta eliminojë. Një qasje e tillë krijon përshtypjen e aplikimit të

standardeve të dyfishta, gjë që është e papranueshme në një proces që duhet të garantojë trajtim të barabartë dhe vendimmarrje të paanshme.
Kur të njëjtat fakte, dokumente dhe rrethana vlerësohen ndryshe nga i njëjti ekspert, varësisht nga operatori ekonomik që merr pjesë në procedurë, krijohet dyshim i arsyeshëm lidhur me objektivitetin, paanshmërinë dhe konsistencën e shqyrtimit. Një qasje e tillë cenon parimin e trajtimit të barabartë dhe krijon perceptimin se për operatorë të ndryshëm aplikohen standarde të ndryshme të vlerësimit.
Besimi ynë në objektivitetin e ekspertit në fjalë është cenuar nga praktika e mëparshme e vendimmarrjes, ku për rrethana të njëjta janë nxjerrë përfundime të ndryshme, në dëm të kompanisë sonë. Për këtë arsye, për të garantuar një shqyrtim të drejtë, të paanshëm, objektiv dhe profesional të kësaj ankese, kërkojmë që lënda t'i caktohet një eksperti tjetër shqyrtues.
Kjo kërkesë nuk paraqet kundërshtim personal ndaj ekspertit, por synon të sigurojë integritetin e procesit të shqyrtimit dhe besimin e palëve në një vendimmarrje të drejtë dhe të bazuar në të njëjtat standarde ligjore për të gjithë operatorët ekonomikë. Në rrethanat e krijuara, konsiderojmë se vetëm caktimi i një eksperti tjetër mund të eliminojë çdo dyshim mbi paanshmërinë e procesit dhe të garantojë trajtim të barabartë të ankesës sonë.

1. AK ka shkelur nenin 1 të LPP-së pasi që gjatë procesit të ri-vlerësimit të ofertave dhe administrimit me procedurën e prokurimit në përgjithësi, nuk ka luajtur rol aktiv për tu siguruar që fondet publike po shfrytëzohen në mënyrë efikase, efektive dhe ekonomike. Kjo nuk është respektuar aspak në rastin konkret sepse Grupet e OE që AK i ka shpallur fitues në lot-in 9 dhe 11, nuk i plotësojnë shumë nga kriteret të përcaktuara paraprakisht në dosje të tenderit për tu cilësuar si të përgjegjshëm e lëre më për tu shpallur fitues.
Krejt kjo ka ardhur si pasojë e mos respektimit në mënyrë të drejtë dhe objektive të kërkesave dhe kritereve të parapara në Njoftimin për Kontratë si dhe në Dosjen e Tenderit nga ana e AK-së. Nga dokumentet tenderuese të këtyre do grupeve të OE-ve, kemi gjetur të dhëna të mjaftueshme që tregojnë se tenderuesit e shpallur fitues në lot-et në fjalë janë tenderues të papërgjegjshëm dhe kanë çmimin më të lartë se ne.
Bazuar në këtë që e thamë më lartë dhe duke marrë për bazë dëshmitë e ofruara nga tenderuesit si dhe duke i krahasuar edhe me çmimet e tyre, konstatohet se AK ka shkelur plotësisht nenin 1 të LPP-së duke mos ri vlerësuar tenderët në përputhje me kërkesat e dosjes së tenderit dhe me kërkesat e LPP-së.

2. AK ka shkelur nenin 7 të LPP-së pasi që gjatë procesit të vlerësimit të ofertave nuk i ka trajtuar të gjithë tenderuesit në mënyrë të barabartë. E themi këtë sepse edhe përkundër mangësive të theksuara në ofertat e Grupeve të OE që i ka shpallur si fitues në Lot-n 9 dhe 11, ato favorizohen duke u shpërblyer me kontratë ndërsa në të njëjtën kohë ne diskriminohemi edhe pse jemi tenderuesi i vetëm i përgjegjshëm që i plotësojmë të gjitha kriteret e dosjes së tenderit dhe se posedojmë çmimin më të ulët.
Vlen të theksohet se tenderuesit e shpallur fitues nuk posedojnë dëshmi të rregullta lidhur me plotësimin e shumë kritereve të dosjes së tenderit. Detajet e mangësive në ofertat e këtyre tenderuesve do ti shpalosim detalisht në pikën 3 ku do të argumentojmë edhe gabimet dhe shkeljen e AK-së me rastin e eliminimit tonë edhe pse si Grup i OE jemi tenderuesi i vetëm i përgjegjshëm në këtë tender.
Bazuar në këtë lirisht mund të themi se AK gjatë procesit të ri vlerësimit ka vepruar plotësisht në kundërshtim me nenin 7 të LPP-së dhe në kundërshtim edhe me parimet bazë të prokurimit mbi trajtimin e drejtë dhe të barabartë të tenderuesve.

3. AK ka shkelur nenin 59 të LPP-së pasi që gjatë ri vlerësimit të tenderëve nuk i ka aplikuar drejtë kërkesat e përcaktuara paraprakisht në dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë. Pika 4 e këtij neni shumë qartë e thotë se:

Autoriteti Kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit.

Këtë parim nuk e ka zbatuar fare gjatë ri vlerësimit sepse edhe përkundër faktit që ne i kemi plotësuar të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit, prap na ka cilësuar të papërgjegjshëm me arsyetime të pabazuara. Ja si duket arsyetimi për eliminimin tonë kinse si tenderues i papërgjegjshëm:

> OE nuk ka plotësuar kërkesat e Dosjes së Tenderit. Fillimisht lidhur me pretendimi e parë ankimor se OE nuk ka ofruar dëshmitë e pajisjeve ashtu si është kërkuar në dosje të tenderit. Paneli Shqyrtues e mbështet plotësisht konstatimet e ekspertit shqyrtues i cili konstaton se kemi të bëjmë me pajisje
> të cilat përveç që nuk janë të regjistruara konform kërkesës së Dosjes së Tenderit, për disa prej tyre nuk janë ofruar as libreza të qarkullimit. Paneli Shqyrtues këtë pretendim e kualifikon të bazuar.Ankuesi pretendon se OE i rekomanduar për kontratë, përkundër kërkesës së dosjes që për Peja 1 duhet të ofrohen 8 kamion, i njëjti ka ofruar 10 kamion :"Tek harta e mirëmbajtjes (Plani veprimit dhe shperndarjes se kripes sipas Specifikacionit teknik te DT) së rrugëve për shpërndarje të kripës grupi i OE të rekomanduar për kontratë ka paraparë 10 kamion (dhjetë kamion) ndërsa janë kërkuar 8 kamionë (Tetë kamionë). Me 10 Kamionë (dhjetë kamion) të llogaritur për reagim ky grup i OE ka dal jashtë kërkesës së dosjes së tenderit deh sepcifikimit teknik të DT dhe nëse llogariten 10 kamion (dhjetë kamion) atëherë shpenzimet i rriten autoritetit 51 kontraktues, prandaj ofertimi në këtë mënyrë e bënë të papërgjegjshme ofertën e tyre. Pra koha maksimale e reagimit është kërkuar që të përgatitet me 8 kamion (tetë kamion) e jo me 10 kamion (dhjetë kamion) siç e ka përllogaritur OE i rekomanduar për kontratë.
> Paneli Shqyrtues edhe këtë pretendim ankimor e kualifikon si të bazuar dhe nuk merr përgjegjësi që të ngarkoj autoritetin kontraktues me kosto shtesë, ngase OE janë të obliguar ti përmbahen planit të vendosur nga AK, po ashtu, duke u bazuar ne analizën e fakteve/dëshmive të dokumentuara ne platformën elektronike e-prokurim, rrjedhën dhe analizën procedurës se prokurimit, OE ankues gjatë fazës se përgatitjes se tenderëve para datës se dorëzimit te tenderëve nuk ka kanë kërkuar sqarime shtese sipas nenit 53 te LPP-së, po ashtu nuk kanë përdorur nenin 108/A te LPP-së qe do te thotë se i kanë kuptuar dhe janë pajtuar me kriteret e përzgjedhjes te përcaktuara ne DT dhe NJK (aneksin 1 te FDT-së) duke pasur te qarte çdo fjali ne dosjen e tenderit si document themelor për përgatitjen e tenderëve - sipas specifikimit teknik dhe Aneksit 1 te FDT-së.

Me qëllimi që të tregojmë se arsyetimet e tilla janë të pabazuara, po japim sqarim për secilin pikë duke i mbështetur pretendimet tona edhe me fakte që tregojnë se ajo që ka thënë AK është e pa bazuar.

1. Kundërshtimi i arsyetimit të parë për eliminim: Ky arsyetim për eliminim duket kështu:

> OE nuk ka plotësuar kërkesat e Dosjes së Tenderit. Fillimisht lidhur me pretendimi e parë ankimor se kemi të bëjmë me pajisje të cilat përveç që nuk janë të regjistruara konform kërkesës së Dosjes së Tenderit, për disa prej tyre nuk janë ofruar as libreza të qarkullimit.

Ky konstatim nuk gjen mbështetje në dokumentacionin e dorëzuar nga OE. Ne kemi paraqitur të gjitha automjetet dhe mjetet e punës që, sipas legjislacionit në fuqi për automjetet, i nënshtrohen detyrimit të regjistrimit, duke i dëshmuar ato me libreza valide të regjistrimit. Ndërkaq, për mjetet dhe pajisjet që nuk i nënshtrohen detyrimit ligjor të regjistrimit, kemi paraqitur dëshmi të pronësisë përmes faturave dhe dokumenteve doganore përkatëse.

Për më tepër, edhe vetë kërkesa e Autoritetit Kontraktues përcakton qartë mënyrën e dëshmimit të pajisjeve, duke kërkuar libreza valide të regjistrimit vetëm për ato mjete për të cilat ekziston detyrimi ligjor i regjistrimit. Në këto rrethana, vlerësimi se OE nuk e ka përmbushur këtë kërkesë nuk është në përputhje me dokumentacionin e dorëzuar dhe as me përmbajtjen e vetë kriterit të tenderit.

:

Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale	9.1 & 9.2	**5. Lista e pajisjeve, mjeteve dhe stabilimenteve teknike që janë të domosdoshme për realizimin e projektit sipas specifikimit teknik, duhet te jete e nenshkruar dhe e vulosur nga OE.**	**Deshmia 5. Pajisjet të cilat regjistrohen duhet të dëshmohen me librezën e regjistrimit (pajisjet duhet te jene me afat te regjistrimit), ndërsa pajisje tjera, OE duhet ti dëshmoj me një dokument për pronësinë e pajisjeve (kontrate te shiteblerjes, faturë, DUD).**

Bazuar në kërkesën e AK-së, si detyrim për regjistrim të automjeteve ka vlejtur vetëm për automjetet që regjistrohen. Ne jemi bazuar ekskluzivisht në Ligjin për Automjetet që aplikohet në Kosovë dhe se të gjitha automjetet janë paraqitur në mënyrë të rregullt. Arsyetimi i tillë për eliminim përpos që është i pa bazuar në këtë ligj, është edhe aplikim selektiv i kërkesës së tillë pasi që edhe vet OE SALLAHU posedon Traktorin, Grejderin, Ngarkuesin dhe Kompresorin pa regjistrim. Kjo tregon se përpos asaj që është aplikuar standard i dyfishtë në raste të njëjta, edhe është shkelur neni 7 i LPP-së me trajtim të pabarabartë të OE dhe me zbatim të kriterit të tillë. Me që AK nuk e ka precizuar se cili nga automjetet apo mjetet tona nuk është paraqitur me librezë regjistrimi, ne nuk po mundemi as me bërë argumentim dhe krahasim të tyre me kërkesat e Ligjit për Automjete dhe me që kërkesa e AK-së nuk e ka precizuar saktë se cili automjet apo mjet duhet të ketë regjistrim, tregon se arsyetimi i tillë përpos që është i pabazuar, është edhe shumë tendencioz. AK ka manipuluar me kërkesën e tillë pasi që edhe OE Lika Company e edhe OE Sallahu, në tenderët e tyre kanë automjete dhe mjete të paregjistruara. Krejt kjo tregon se AK ka aplikuar standard të dyfishtë kur ishte në pyetje vlerësimi i tenderit tonë dhe tenderëve të këtyre dy kompanive. Mos aplikimi i drejtë dhe i saktë i kërkesës në fjalë dhe mos marrja për bazë e ligjit për automjete të Kosovës e shtynë AK-në drejt shkeljes së plotë të nenit 59 të LPP-së. Për më tepër kemi edhe raste ku vet AK në procedurën e njëjtë madje edhe ka nënshkruar kontrata me OE që gjithashtu nuk i kanë pasur të regjistruara automjete e tilla ngjashëm ne dhe dy konkurrentët që i cekëm më sipër. Tani shtrohet pyetja, pse u dashka vetëm tek ne të aplikohet një kriter i tillë i paligjshëm dhe se a po shihet kjo si një diskriminim i hapur ndaj tenderit tonë. Krejt kjo përkon me shkelje të plotë të nenit 59 të LPP-së por edhe me shkelje të nenit 53.6 të LPP-së sepse kriteri për regjistrim të disa automjeteve dhe mjeteve po aplikohet edhe si kriter shtesë që nuk ishte fare në dosjen e tenderit.

2. Kundërshtimi i arsyetimit të dytër për eliminim: Ky arsyetim për eliminim përpos që është i pasaktë është edhe i manipuluar sepse AK ka abuzuar me të dhënat e numrit të kamionëve të kërkuar nëpër lot-e. Para se të fillojmë kundërshtimin e arsyetimit të eliminim nëpër Lot-et e cekura, po e paraqesim arsyetimin për eliminim të përshkruar nga AK dhe po e kundërshtojmë aplikimin e kërkesës në kundërshtim me dosjen e tenderit dhe në kundërshtim edhe me nenin 56.3 të LPP-së:

> OE i rekomanduar për kontratë, përkundër kërkesës së dosjes që për Peja 1 duhet të ofrohen 8 kamion, i njëjti ka ofruar 10 kamion :"Tek harta e mirëmbajtjes (Plani veprimit dhe shperndarjes se kripes sipas Specifikacionit teknik te DT) së rrugëve për shpërndarje të kripës grupi i OE të rekomanduar për kontratë ka paraparë 10 kamion (dhjetë kamion) ndërsa janë kërkuar 8 kamionë (Tetë kamionë). Me 10 Kamionë (dhjetë kamion) të llogaritur për reagim ky grup i OE ka dal jashtë kërkesës së dosjes së tenderit deh sepcifikimit teknik të DT dhe nëse llogariten 10 kamion (dhjetë kamion) atëherë shpenzimet i rriten autoritetit 51 kontraktues, prandaj ofertimi në këtë mënyrë e bënë të papërgjegjshme ofertën e tyre. Pra koha maksimale e reagimit është kërkuar që të përgatitet me 8 kamion (tetë kamion) e jo me 10 kamion (dhjetë kamion) siç e ka përllogaritur OE i rekomanduar për kontratë.

Fillimisht duhet të sqarojmë se kërkesa për numrin e kamionëve nuk ka qenë fikse sipas asaj që

manipulon AK në këtë arsyetim dhe se sasia e kamionëve të cekur ka qenë vetëm si vlerë minimale e tyre. Kërkesa tek pika b në faqen 101 dukej kështu: **b) <u>Kërkesat minimale për pajisje dimërore për secilin Llot,</u>** <u>ku e njëjta ishte potencuar edhe në</u> tabelë që duket kështu:

3	Kërkesat minimale për pajisje dimërore për regjion	KËRKUAR PËR LOT				Të dhënat për pajisjet: (Viti i prodhimit gjendja e pajisjes regj. targave me afat regjistrimi, dëshmitë mbi pronësinë ose kontratë për huazim, foto etj)
		LOT 1	LOT 2	LOT 3	LOT 4	
3.1	Automjetet rrugore për patrullime shërbimi	2	2	2	2	
3.2	Automjete transportuese (kamion) të pajisur me Borëheqëse (Pllugjet) dhe Shpërndarësit automatik të kripës me kapacitet min. të motorit 110 KW	10	9	8	7	

Pra sasia e kamionëve ka qenë **vetëm si përkufizim minimal** e **jo përkufizim fiks** i numrit të kamionëve. Kjo nuk ka kuptim sidomos kur dihet që AK do të **paguaj kohën e pastrimit sipas numrit minimal të kamionëve dhe kërkesave nga vet AK.** Pra AK do të paguajë vetëm sasitë e vendosura nga ata dhe se angazhimi i pjesës shtesë të kamionëve nuk do të kërkohet që të paguhet. Ky arsyetim nuk qëndron fare si dhe është plotësisht i pasaktë dhe i pabazuar edhe për faktin se numri prej 8 kamionëve për Lot 9 ka qenë vetëm si vlerë minimale e përcaktuar nga vet AK në tabelën e pajisjeve të kërkuara (*shihe kërkesën në DT*). Kohën maksimale të reagimit prej 1.5 orë ne kemi dashur ta arrijmë në mënyrë komode dhe të sigurt por **kjo nuk do të thotë se AK do të faturohet për pjesën e shtuar të kamionëve.** E njëjta vlen edhe për numrin e orëve të kujdestarisë së kamionëve dhe stafit ku faturimet e tilla do të bëhen vetëm sipas sasisë së parashikuar nga AK si sasi minimale për angazhim. Vlen të thuhet edhe kjo se AK e ka kontestuar shtimin e kamionëve tek ne ndërsa faktin real që disa Grupe të OE që janë shpallur edhe si fitues e kanë shkurtuar gjatësinë e rrugëve në krahasim me gjatësitë e paraqitura tek dosje e tenderit nga vet AK duke manipuluar atë për të vetmin qëllim arritjen e kohës minimale të intervenimit, AK nuk i ka sanksionuar fare. Për këtë do ju njohim në vazhdim të pretendimeve.

Pra me që përdorimi i numrit të shtuar të kamionëve e ka ulur kohën efektive të përgjithshme në masë të madhe dhe me që pagesa për shërbimin e tillë bëhet sipas sasive të përcaktuara nga vet AK si sasi minimale, ndikimi në kosto është pozitiv e jo ashtu siç e ka potencuar AK-ja në arsyetimin për anulim. Pra ne kemi paraqitur saktë kohën e intervenimit e cila përbëhet nga koha e përshkrimit të rrugës së vdekur dhe nga koha e përshkrimit të dyanshëm të rrugës efektive, dhe se konstatimi i AK-së për atribuim të kësaj si

mangësi në tenderin tonë është plotësisht e gabuar. Për më saktë duhet të i referoheni fillimisht kërkesës së dosjes së tenderit dhe ta bëni krahasimin me tenderin tonë përkatësisht me planin e shpërndarjes së kripës që është paraqitur në ofertë e sidomos atë për Lot-in 9 dhe Lot-in 11.
AK ka shkelur nenin 59 të LPP-së edhe kur I ka cilësuar të përgjegjshëm tenderuesit që më pas edhe i ka shpallur fitues në Lot-in 9 dhe në Lot-in 11. Për të dëshmuar këtë po ju njohim me mangësitë e tyre në Lot-et përkatëse:

- Mangësitë në tenderit të **Grupit të OE "Lika Company SH.P.K. & MIRUSHA COMPANY SH.P.K." tek Lot 9** janë si në vazhdim.

Ky Grup i OE ka dorëzuar dëshmi lidhur me kërkesën për Dëshmitë me të dhënat e objekteve përcjellëse por si të tilla **nuk janë të rregullta.** E themi këtë sepse secila kontratë (4 kontrata të oferuara) për marrje me qera të parcelave, **është e pavlefshme sepse kontrata është e hartuar në emër të kompanisë Lika Trade SH.P.K.** me nr. unik identifikues përkatës edhe pse si kompani nuk është fare pjesëmarrëse në GOE ku edhe është paraqitur dëshmia në fjalë. Kjo mangësi e bënë dokumentin e tillë të pavlefshëm ndërsa GEO në fjalë **e bënë plotësisht të papërgjegjshëm.** Ja si duken të dhënat nga dëshmitë e tilla të paraqitura vetëm vizualisht, ndërsa si të plota mund ti gjeni tek tenderi i këtij Grupi të OE-ve.

-I- Palët Kontraktuese

1. **Z Salih (HAXHI) Likaj,** i lindur me datë 04.09.1959 në fshatin Carrabreg i Ulët Komuna Deçan ku dhe banon Shtetas i Republikës së Kosovës me nr. personal **1009518190** të lëshuar me datë 21.05.2021 me afat vlefshmërie dhjetë vjeçar,
Z Shefqet (HAXHI) Likaj, i lindur me datë 25.02.1963 në fshatin Carrabreg i Ulët Komuna Deçan ku dhe banon Shtetas i Republikës së Kosovës me nr. personal **200978476** të lëshuar me datë 25.03.2015 me afat vlefshmërie dhjetë vjeçar,
Z Fadil (HAXHI) Likaj, i lindur me datë 10.12.1968 në fshatin Carrabreg i Ulët Komuna Deçan ku dhe banon Shtetas i Republikës së Kosovës me nr. personal **1030758109** të lëshuar me datë 08.01.2015 me afat vlefshmërie dhjetë vjeçar,
me zotësi të veprimit ne tekstin vijues ne cilësinë e **Qiradhënësi;**

2. **„Lika Trade" SH.P.K** me numër unik indetifikues **810218116** me seli në fshatin Isniq Komuna Deçan të cilin ndërmarrje e përfaqëson Sali(Haxhi) Likaj i lindur me datë 04.09.1959 në fshatin Carrabreg i Ulët Komuna Deçan ku dhe banon shtetas i Republikës se Kosovës, i cili identifikohet me Letërnjoftim me nr. personal **1009518190** të lëshuar me datë 21.05.2021 me afat vlefshmërie dhjetë vjeçar , ne tekstin vijues ne cilësinë e **Qiramarrësi**

Qiradhënësi:

Salih (HAXHI) Likaj

Shefqet (HAXHI) Likaj

Fadil (HAXHI) Likaj

Qiramarrësi:

„Lika Company" SH.P.K

Emri	Emri tregtar	NUI	Komuna	Li
Lika Trade SH.P.K.	—	810218116	Deçan	Sh

PRONARËT	PËRFAQËSUESIT	KONTAKTI
Sali Likaj, Fadil Likaj	Sali Likaj, Fadil Likaj	+38344179343

Sipas këtyre mangësive të GOE, AK është dashur ta konsideroj plotësisht të pa përgjegjshëm e jo ta shpërblej me kontratë tek Lot-i 9.

- Mangësitë në tenderit e **Grupit të GOE "SALLAHU SH.P.K. & NDËRTIMI SH.P.K."** janë si në vazhdim.

- **Mangësia e parë** e identifikuar në ofertën e Grupit të OE "SALLAHU SH.P.K. & NDËRTIMI SH.P.K." ndërlidhet me dokumentin **"Deklarata e Themelimit të Grupit"** (PDF 1), konkretisht në faqen 3.
  Nga shqyrtimi i këtij dokumenti konstatohet qartë se në pjesën e rezervuar për **"Data/Nënshkrimi/Vula"** të përfaqësuesit të autorizuar të Grupit të Operatorëve Ekonomikë mungon **VULA** e subjektit. Vetë formulari i përdorur nga operatori ekonomik parasheh në mënyrë eksplicite që dokumenti të përmbajë **jo vetëm nënshkrimin, por edhe vulën,** si element përbërës të vlefshmërisë së deklarimit.
  Prania e rubrikës së veçantë "Vula" në formular e bën të padiskutueshme natyrën obligative të saj. Mosvendosja e vulës përbën mospërmbushje të një kërkese të shprehur të dokumentit dhe e bën deklaratën formalisht të paplotë.
  Mungesa e vulës në këtë rast nuk mund të konsiderohet lëshim i parëndësishëm formal, pasi bëhet fjalë për dokumentin themelor për krijimin dhe përfaqësimin e Grupit të Operatorëve Ekonomikë. Pikërisht përmes këtij dokumenti përcaktohen marrëdhëniet ndërmjet anëtarëve të grupit dhe autorizimi i liderit për të vepruar në emër të tyre. Për rrjedhojë, mosplotësimi i një elementi të kërkuar shprehimisht në dokument cenon vlefshmërinë formale të deklarimit dhe krijon paqartësi lidhur me konfirmimin zyrtar të përmbajtjes së tij.



- **Mangësia e dytë** e identifikuar në ofertën e tenderuesit në fjalë ndërlidhet me dokumentin PDF 12, konkretisht me Menaxherin e Projektit, z. Leke Krasniqi.
  Nga shqyrtimi i CV-së së dorëzuar në emër të këtij personi konstatohet se nuk evidentohet asnjë projekt i natyrës së mirëmbajtjes së rrugëve, ndonëse përvoja në projekte të tilla është kërkuar shprehimisht në dosjen e tenderit. Për më tepër, për z. Krasniqi nuk është dorëzuar asnjë referencë apo dëshmi që vërteton realizimin ose menaxhimin e ndonjë projekti të mirëmbajtjes së rrugëve, sipas kërkesave të Autoritetit Kontraktues.
  Për rrjedhojë, tenderuesi nuk ka arritur të dëshmojë se personi i propozuar për pozitën e Menaxherit të Projektit i plotëson kërkesat minimale të përcaktuara në dosjen e tenderit. Ky fakt vërtetohet qartë nga përmbajtja e CV-së së dorëzuar, e cila nuk përmban asnjë përvojë relevante në projekte të mirëmbajtjes së rrugëve.

- **Mangësia e tretë** e identifikuar në ofertën e tenderuesit në fjalë ndërlidhet me dokumentin PDF 13, konkretisht me Inxhinierin e Komunikacionit, z. Ilmi Fetaj.
  Nga shqyrtimi i CV-së së dorëzuar në emër të këtij personi konstatohet se nuk është paraqitur asnjë përvojë në udhëheqjen apo angazhimin në projekte të mirëmbajtjes së rrugëve, ndonëse një përvojë e tillë është kërkuar shprehimisht në dosjen e tenderit. CV-ja e dorëzuar nuk përmban dëshmi apo përshkrim të ndonjë projekti relevant që do të vërtetonte përmbushjen e këtij kriteri.
  Për rrjedhojë, tenderuesi nuk ka arritur të dëshmojë se personi i propozuar për pozitën e Inxhinierit të Komunikacionit i plotëson kërkesat e përcaktuara në dosjen e tenderit. Ky fakt vërtetohet qartë nga vetë CV-ja e dorëzuar në emër të z. Ilmi Fetaj.

- **Mangësia 4** tek tenderuesi në fjalë ndodhet tek **Makineria dhe paisjet përkatësisht tek një numër i konsiderueshëm i tyre: Në vazhdim po i paraqesim për secilën veç e veç:**

Mjeti i kërkuar tek **Pika 1.8 Kompresor ajri** nuk është ofruar dhe dëshmuar sipas kërkesës së dosjes pasi që atë e ka ofruar në shasi mbi dy rrota por nuk e ka ofruar regjistrimin për të. Shih dëshminë tek - **Pdf 26 faqe 28;**

Mjeti i kërkuar tek **Pika 1.13 Traktor me rimorkio** me fuqi min. 40kw nuk është ofruar dhe dëshmuar sipas kërkesës së dosjes së tenderit sepse nuk është ofruar fare librezë e regjistrimit për të dhe nuk është ofruar fare as rimorkio si pjesë e kërkesës së pikës në fjalë. Si dëshmi shihe me kujdesë dokumentin **Pdf 26, Faqe 38.**

Mjeti i kërkuar tek **Pika 1.14 Kositëse e e barit qe vendoset ne traktor** nuk është ofruar dhe dëshmuar si pas kërkesës sepse në vend të kositëses që vendoset në traktor është ofruar pajisje me 4 rrota me benzinë për kositje te barit për kopsht. Shihe dëshminë tek dokumentacioni i tenderit.

Mjeti i kërkuar tek **Pika 1.15 Fshesë e dorës për fryerje, me djegëje me benzin** nuk ka ofruar e as dëshmuar fare.

Mjeti i kërkuar tek **Pika 1.18 Kamion me rimorkio per transport te makinerisë,** nuk është ofruar dhe dëshmuar si duhet sepse nuk e ka ofruar Rimorkion ashtu siç është kërkuar.

- **Mangësia e pestë** e identifikuar në ofertën e tenderuesit në fjalë ndërlidhet me dokumentin **PDF 24, faqet 10, 11 dhe 12**, ku është paraqitur kalkulimi i kohës së intervenimit.
  Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezulton se tenderuesi ka kalkuluar gabimisht kohën e intervenimit, pasi në përllogaritje ka marrë parasysh **vetëm kohën e vajtjes**, duke mos llogaritur edhe **kohën e kthimit**, ndonëse Dosja e Tenderit kërkon qartë përllogaritjen e plotë të kohës së intervenimit.
  Për pasojë, koha e paraqitur nga tenderuesi nuk pasqyron kohën reale të intervenimit dhe krijon një paraqitje të pasaktë të përmbushjes së kërkesës. **Nëse kalkulimit të paraqitur i shtohet edhe koha e kthimit, koha totale e intervenimit tejkalon kohën maksimale të lejuar sipas Dosjes së Tenderit**, çka nënkupton se kriteri përkatës nuk është përmbushur.

Për rrjedhojë, tenderuesi nuk ka arritur të dëshmojë përmbushjen e kërkesës së përcaktuar nga Autoriteti Kontraktues, ndërsa dokumentacioni i dorëzuar përmban një **kalkulim të pasaktë dhe jo në përputhje me kërkesat e tenderit**, gjë që e bën ofertën e tij të papërgjegjshme në raport me këtë kriter. Për këtë fakt, ju lutemi t'i referoheni me kujdes dëshmisë dhe kalkulimeve të paraqitura në dokumentin përkatës.

- **Mangësia e gjashtë** e identifikuar në ofertën e tenderuesit në fjalë ndërlidhet me dokumentin **PDF 30 – Konfirmimi Bankar**.
  Nga shqyrtimi i këtij dokumenti konstatohet se konfirmimi bankar i dorëzuar nuk e përmbush kërkesën e Dosjes së Tenderit në formën e kërkuar. Autoriteti Kontraktues ka kërkuar që mbështetja financiare të ofrohet **në mënyrë të pakushtëzuar**, ndërsa konfirmimi i dorëzuar përmban **kushte dhe kufizime të qarta**, të cilat e kushtëzojnë disponueshmërinë e mjeteve financiare.
  Për rrjedhojë, dokumenti i paraqitur nuk mund të konsiderohet si dëshmi e mbështetjes financiare të pakushtëzuar, ashtu siç është kërkuar shprehimisht nga Autoriteti Kontraktues. Ekzistimi i kufizimeve në vetë përmbajtjen e konfirmimit bankar e bën këtë dokument të papërshtatshëm për të dëshmuar përmbushjen e kriterit përkatës.
  Ky fakt evidentohet qartë nga përmbajtja e konfirmimit bankar dhe kufizimi i përfshirë në të, të cilit ju lutemi t'i referoheni në dëshminë e paraqitur më poshtë.

LETTER OF INTENT

We have been informed by the Legal Entity SALLAHU SH.P.K., address Str. Baki Dullovi, no.158, with business number 810135237 and unique identification number/NUI 810135237, that it has been required the letter of intent regarding the tender published by Ministry of Infrastructure with title: Summer and winter maintenance of national and regional roads in Kosovo for the next 3 years, with procurement/reference no: 205-25-4397-2-1-1.

We, NLB Banka sh.a., hereby inform you that the Legal entity SALLAHU SH.P.K., with business no. 810135237 and NUI 810135237, is the client of our Bank and that the same uses Bank's products and services.

This Legal entity has realized a turnover in our Bank and has proved to be serious in meeting its different contractual obligations towards our Bank.

In case the Legal entity SALLAHU SH.P.K. requests financial support regarding the above-mentioned project/tender, for the amount up to but not exceeding **EUR 600,000.00** (in words: EUR sixhundredthousand), the Bank will review its financing, based on the Bank's internal procedures.

Sincerely yours,

Arjanit Krasniqi
Senior Corporate Officer

Dafina Hasani
Head of Corporate Division

Prandaj, bazuar në të gjitha mangësitë e lartcekura, rezulton qartë se tenderuesi në fjalë nuk i ka përmbushur kërkesat e Dosjes së Tenderit dhe si i tillë është dashur të konsiderohej **operator ekonomik i papërgjegjshëm**. Përkundër kësaj, Autoriteti Kontraktues jo vetëm që nuk e ka eliminuar ofertën e tij, por e ka shpërblyer atë edhe me kontratë, veprim ky që përbën shkelje të qartë të dispozitave ligjore të përmendura më sipër, e në veçanti të **nenit 59 të LPP-së**, i cili obligon AK-në që kontratën ta japë vetëm operatorit ekonomik të përgjegjshëm.
Në rrethana të tilla, AK është dashur ta shpallte këtë tenderues të papërgjegjshëm dhe ta eliminonte nga procedura, e jo ta shpërblente me kontratë për **Lotin 11**.
Për më tepër, bazuar në të gjitha argumentet dhe faktet e paraqitura në këtë kërkesë, si dhe në dokumentacionin e siguruar nga vetë Autoriteti Kontraktues, rezulton se eliminimi i ofertës sonë ka qenë i pabazuar dhe në kundërshtim me kërkesat e Dosjes së Tenderit, ndërsa vlerësimi i operatorëve ekonomikë të shpallur fitues është bërë në kundërshtim me kriteret dhe kërkesat e përcaktuara paraprakisht.
Si rezultat, procesi i vlerësimit nuk ka qenë objektiv, i drejtë dhe në përputhje me dispozitat e LPP-së, duke çuar në një vendimmarrje të gabuar dhe në shkelje të nenit 59 të LPP-së.
Për këto arsye, i propozojmë Autoritetit Kontraktues që të aprovojë këtë kërkesë për rishqyrtim, të anulojë vendimin e kontestuar, ta kthejë procedurën në rivlerësim dhe të kryejë një vlerësim të ri në përputhje me kërkesat e Dosjes së Tenderit dhe dispozitat e LPP-së. Vetëm përmes një rivlerësimi të drejtë dhe të ligjshëm mund të sigurohet trajtimi i barabartë i operatorëve ekonomikë dhe përzgjedhja e ofertës që realisht i përmbush të gjitha kërkesat e përcaktuara nga Autoriteti Kontraktues.

- **Mangësia e shtatë** e identifikuar në ofertën e tenderuesit në fjalë ndërlidhet me **Paramasën e Lot-it 11**, konkretisht me **pozicionin 4.1.2**.
  Sipas kërkesës së Dosjes së Tenderit (faqe 81), për **Pozicionin 4.1.2 – Koha e kujdestarisë 24 orë për kamion të pajisur me borëpastruese dhe hedhëse të kripës**, çmimi i ofertuar **nuk mund të jetë më i madh se 15% e vlerës së Parallogarisë 4**.
  Në ofertën e **GOE SALLAHU SH.P.K.**, për pozicionin 4.1.2 është ofertuar çmimi prej **35.00 €**, ndërsa vlera totale e Parallogarisë 4 është **203.00 €**.
  Nga kalkulimi rezulton se çmimi i ofertuar për këtë pozicion përbën:
  35.00 € / 203.00 € × 100 = 17.24%
  Pra, tenderuesi ka ofertuar **17.24%** të vlerës së Parallogarisë 4, ndërsa Dosja e Tenderit ka lejuar maksimumi vetëm **15%**.
  Rrjedhimisht, oferta e tenderuesit është në kundërshtim të drejtpërdrejtë me kërkesën e Dosjes së Tenderit dhe si e tillë është dashur të konsiderohej e papërgjegjshme dhe të eliminohej nga procedura e vlerësimit.
  Parallogari e GOE:

Paralllogaria 4		Intervenimet, kujdestaria dimërore dhe materialet për shpërndarje			
4	Përshkrimi i pozicionit	Njësia	Sasia	Çmimi njësi me TVSH (€)	Totali me TVSH (€)
4.1	Intervenimet dhe kujdestaria				
4.1.1	Orët efektive dhe të udhëtimeve për kamionët në intervenim me borëpastruese dhe hedhëse të kripës.	orë	1.00	65.00 €	65.00 €
4.1.2	Koha e kujdestarisë 24 orë për kamion të pajisur me borëpastruese dhe hedhëse të kripës. (Numri i kamionëve kujdestar përcaktohet nga menaxheri në varesi nga kushtet e parapara atmosferike, periudha e percaktimit definohet në specifikacion teknik).	ditë	1.00	35.00 €	35.00 €
4.2	Materiali dhe Shpërndarja				
4.2.1	Furnizimi me kripë. Deri në fund të muajit Nëntor të çdo viti, me sasi min. 750 ton. Sasia shtesë e furnizimit me kripë caktohet nga organi mbikëqyrës.	ton	1.00	80.00 €	80.00 €
4.2.2	Ngarkimi dhe shpërndarja e kripës nëpër rrugë.	ton	1.00	20.00 €	20.00 €
4.2.3	Furnizimi me rërë.	m^3	1.00	2.00 €	2.00 €
4.2.4	Ngarkimi dhe shpërndarja e rërës nëpër rrugë.	m^3	1.00	1.00 €	1.00 €
	Gjithsej çmimi njësi me TVSH (€):				203.00 €
4	Pesha (%):				34.00%
	Gjithsej çmimi njësi i peshuar me TVSH (€):				69.02 €

4. AK ka shkelur nenin 60 të LPP-së pasi që nuk ka respektuar kërkesat e dosjes së tenderit të vendosura në përputhje me LPP-në dhe si pasojë e kësaj ka shpërblyer me kontratë dy Grupe të OE-ve që janë të papërgjegjshëm. Për tu aplikuar kriteri i vlerësimit Çmimi më i ulët, Grupet e OE-ve së pari duhet të vlerësohen për nga përgjegjshmëria e që në këtë rast nuk janë vlerësuar fare sipas kërkesave të dosjes së tenderit. Grupet e OE-ve të shpallura fituese janë të papërgjegjshëm dhe realisht nuk do duhej të kalonin fare tek pjesa e krahasimit për nga çmimet. Pavarësisht kësaj, ne kemi pasur çmimet më të ulët në të dy Lot-et andaj mos shpërblimi i tenderit tonë me së paku njërin Lot është jo ligjore dhe shumë e pa drejtë. Për më saktë çmimi jonë i poentuar në Lot 9 ka qenë 314.15€ ndërsa GOE i shpallur fitues në Lot 9 ka çmimin e poentuar 505.88€ që i bie të jetë afërsisht 62% më i lartë. Po ashtu, çmimi jonë i poentuar në Lot 11 ka qenë 314.15€ ndërsa GOE i shpallur fitues në Lot 11 ka çmimin e poentuar 1,222.46€ që i bie të jetë afërsisht 290% më i lartë. Pra po shihet qartë se me plotë të drejtë kjo konsiderohet shkelje e plotë e nenit 60 të LPP-së.

5. AK ka shkelur nenin 69 të LPP-së pasi që nuk ka respektuar kërkesat e dosjes së tenderit të vendosura në përputhje me nevojat e projektit. AK ka vendosur shumë kritere dhe kërkesa që lidheshin me nenin 69.4 të LPP-së por që asnjërën nga këto kritere nuk i ka zbatuar si duhet gjatë procesit të vlerësimit. Shumicën e këtyre kritereve i ka anashkaluar kur ishte në pyetje vlerësimi i tenderëve të shpallur fitues. Këtu përpos që kemi të bëjmë e mos aplikim të drejtë të kritereve të dosjes dhe kërkesave të nenit 69.4 të LPP-së, kemi të bëjmë edhe me favorizim të Grupeve të OE-ve të shpallura fitues dhe me diskriminim të grupit tonë si tenderuesi i vetëm i përgjegjshëm në radhët e tenderuesve që ishin konkurrent në këto dy Lot-e. Krejt kjo tregon hapur se AK ka shkelur plotësisht nenin 69 të LPP-së.

6. AK ka shkelur nenin 72 të LPP-së dhe **nenin 38 të RRPP-001/2022** pasi që nuk i ka respektuar fare detyrimet ligjore dhe këshilluese që dalin nga dispozitat e tilla. Këto dispozita janë shkelur për faktin që AK nuk ka kërkuar sqarime shtesë nga ne lidhur me të dhënat mbi bazën e të cilave na ka eliminuar nga konkurrenca edhe pse shihet se ka pasur paqartësi të

madhe në këtë drejtim. Mos respektimi i dëshmive kualifikuese të tenderit tonë dhe refuzimi i tenderit në fjalë pa kërkuar asnjë sqarim apo plotësim ligjor të tenderit tonë, e shtynë AK-në drejt shkeljes së plotë të nenit **72 të LPP-së,** dhe **nenit 38 të RRPP-001/2022**.

7. **AK ka shkelur nenin 108/A të LPP-së.**

Përveç mosshqyrtimit objektiv të pretendimeve tona, nga mënyra e vlerësimit të ofertave krijohet dyshimi serioz se Autoriteti Kontraktues ka zbatuar standarde të ndryshme të vlerësimit ndaj operatorëve ekonomikë, në kundërshtim me parimin e trajtimit të barabartë dhe mosdiskriminimit, të përcaktuar në Ligjin për Prokurimin Publik.

Konkretisht, ne disponojmë dëshmi se operatorë të tjerë ekonomikë, të cilët kanë pasur mangësi dukshëm më të mëdha në ofertat e tyre, nuk janë eliminuar nga procedura dhe madje janë shpallur fitues. Si shembull, operatori ekonomik "X" në aktivitetin përkatës (Prishtina 1), si dhe operatori ekonomik "Lika Company", kanë pasur mangësi materiale që tejkalojnë mangësitë e pretenduara në ofertën tonë, megjithatë këto mangësi nuk janë konsideruar si arsye për eliminim.

Nga dokumentacioni i procedurës rezulton se Autoriteti Kontraktues ka aplikuar standarde të dyfishta gjatë vlerësimit të ofertave. Në disa raste janë pranuar pajisje pa dëshmi të regjistrimit, ndërsa në raste të tjera është kërkuar regjistrimi si kusht vendimtar për pranueshmërinë e ofertës. Një praktikë e tillë tregon mungesë konsistence në zbatimin e kritereve të njëjta ndaj të gjithë operatorëve ekonomikë dhe përbën shkelje të parimeve të trajtimit të barabartë, proporcionalitetit, transparencës dhe konkurrencës së ndershme.

Për këtë arsye, konsiderojmë se është e domosdoshme që organi shqyrtues të kryejë një ekspertizë dhe analizë krahasuese të të gjitha ofertave, duke i vlerësuar ato sipas të njëjtave kritere dhe standarde. Një analizë e tillë do të dëshmonte lehtësisht se Autoriteti Kontraktues nuk ka zbatuar kritere uniforme gjatë vlerësimit, por ka trajtuar operatorët ekonomikë në mënyrë selektive.

Rrjedhimisht, ekzistojnë dyshime të bazuara se vlerësimi nuk është zhvilluar në mënyrë të paanshme dhe objektive, por është karakterizuar nga aplikimi selektiv i kritereve, gjë që ka krijuar një avantazh të pajustifikuar për operatorë të caktuar ekonomikë dhe ka cenuar parimet themelore të procedurës së prokurimit publik. Për këtë arsye, kërkojmë që këto rrethana të shqyrtohen në mënyrë të plotë dhe të paanshme nga organi kompetent, përmes një rivlerësimi të bazuar në të njëjtat standarde për të gjithë operatorët ekonomikë.

Bazuar në krejt këtë që theksuam më lart kërkojmë nga AK që të merr:

V E N D I M

I. <u>APROVOHET</u> si e bazuar kërkesa për rishqyrtim e Grupit të OE **"2A Group SH.P.K. & VIA EGNATIA SH.P.K."** lidhur me tenderin **"Mirëmbajtja verore dhe dimërore e Rrugëve Nacionale dhe Rajonale të Kosovës për 3 vitet në vazhdim LOT 9 (Peja 1) dhe LOT 11 (Prishtina 1)" i iniciuar nga MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS.**

II. <u>ANULOHET</u> Njoftimi mbi Vendimin e AK - **MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS** për **Lot-et 9 dhe 11** dhe lënda të kthehet në **RI-VLERËSIM.**

Ri-vlerësimi të bëhet plotësisht bazuar në kërkesat e dosjes së tenderit dhe të LPP-së ku më pas do duhej që si **FITUES** për së paku një Lot të shpallej **Grupi i OE "2A Group SH.P.K. & VIA EGNATIA SH.P.K."**

8. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar ka shkaktuar ose kërcënohet t'iu shkaktojë dëme materiale, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Dëmet materiale që na shkaktohen nëse ne nuk e marrim këtë kontratë janë të konsiderueshme si në fushën financiare, fitime të munguara, dhe mos mundësi e kompensimit të shpenzimeve përgatitore për këtë kontratë.

9. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni kërkesës dokumentet e renditura më poshtë:



Vërejtje: Dëshmitë e dokumenteve tjera të kontestuara lidhur me vlerësimin e AK-së i gjeni edhe në dokumentacionin e procedurës dhe tenderët e dy GOE përfshi edhe atë tç tenderit tonë.